



BASHKIA
TIRANË
REPUBLIKAVE SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 143, datë 30.10.2020

**PËR
EMËRTIMIN “NEXHMIJE PAGARUSHA” TË KOPSHTIT NË PARKUN E MADH
TË LIQENIT ARTIFICIAL NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja “b”, nenit 25 pika 3, nenit 54 shkronja “ll” dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; vendimit nr. 219, datë 21.3.2017, të këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pjesshme (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të njësisë Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë, të Qarkut të Tiranës”, të ndryshuar; vendimit nr. 33 datë 23.05.2016, të Këshillit Bashkiak “Për kalimin e Parkut të Madh të Liqenit Artificial, Tiranë (asetet e ndodhura në të), Varrezat e Dëshmorëve Sauk, Kopshti Zoologjik, nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, kalimin e Amfiteatrit të Parkut të Madh të Liqenit Artificial nga Ndërmarrja e Dekorit në administrim të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit” si dhe në vijim të memos nr. 18466/1, datë 17.06.2020 si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak i Tiranës,

V E N D O S I:

1. Emërtimin “Nexhmije Pagarusha” të kopshtit me vendndodhje në Parkun e Madh të Liqenit Artificial, në Njësinë Administrative Nr. 2, sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur.
 2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

K R Y E T A R

TONI GOGU